



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:029300
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05625544
KPPP.nr. 166/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Inspektorati i Punës”, me seli në Pejë, kundër debitorit “Unicron” SH.P.K. me numër unik të identifikimit 810747090, me adresë në Fusha e Pejës Zona Industriale p.n., Pejë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 3410/23 të datës 28.12.2023, të Përmbaruesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Unicron” SH.P.K., dhe Urdhri Përmbarimor P.nr. 3410/23 të datës 28.12.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Blerim Baloku, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Inspektorati i Punës” ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 3410/23 të datës 28.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Vendimit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës Nr. 296/23 të datës 27.07.2023 dhe Vendimit të shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës Nr. 483/23 të datës 24.10.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 8,000.00€ (tetë mijë euro) me kamatë ligjore duke filluar prej paraqitjes së propozimit për ekzekutim, deri në pagesën përfundimtare, me ndalim të qarkullimit të mjeteve në xhirollogarinë e debitorit dhe llogarive tjera ndihmëse në BPK, ose pasurisë së debitorit deri në bartjen e shumës së cekur më lartë në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi urdhrin përmbarimor, duke theksuar se urdhri përmbarimor është i papërshtatshëm për përmbarim pasi që përmbaruesi nuk ka kompetencë sepse kreditori është institucion publik dhe për përmbarimin për akte administrative të administratës shtetërore, Administrata Tatimore e

Kosovës ka kompetencë ekskluzive. Tutje ka shtuar se vendimet e bashkangjitura në urdhrin përmbartimor nuk kanë titull ekzekutiv dhe se nuk i plotësojnë kushtet e parapara me ligj, duke konsideruar lejimin e përmbartimit si të kundërligjshëm ndërsa ka shtuar se urdhri përmbartimor nuk ka tipare të përmbartueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbartim sipas Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Sipas nenit 22 par.1 të LPP-së, janë përcaktuar dokumentet përmbartuese ndërsa me par.1 nën par. 1.2 të këtij neni, si dokument përmbartues përcaktohet: *“vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (më tej: ujdia)”*, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Vendimi i shkallës së parë të Inspektoratit të Punës Nr. 296/23 të datës 27.07.2023 dhe Vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës Nr. 483/23 të datës 24.10.2023, mbi të cilët mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbartim e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”* ngase Vendimi i shkallës së parë të Inspektoratit të Punës Nr. 296/23 të datës 27.07.2023 dhe Vendimi i shkallës së dytë të

Inspektoratit të Punës Nr. 483/23 të datës 24.10.2023 të marrë nga Inspektorati i Punës nuk përmbajnë vulën e përmbareshmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbareshmërisë, dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbareshmërisë duhet të anulohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.166/24, datë 26.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.